



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-052-08-3131-24

Nr. i fq. / Br.str. / No.pg. _____

Data / Datum / Date 31. 01. 2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KOMUNA E OBILIQIT

RAPORTI VJETOR JANAR-DHJETOR 2023
(RAPORTI VJETOR I KONSULTIMEVE PUBLIKE)

OBILIQ 2023



HYRJJE

Konsultimi publik nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, me qëllim të marrjes së opinioneve, sugjerimeve, kërkesave dhe vërejtjeve të tyre, gjatë zhvillimit të procedurave të hartimit të politikave, dokumenteve strategjike dhe akteve nënligjore të kuvendit komunal.

Komuna e Obiliqit gjatë këtij viti ka bërë përpjekje që të tërheqë sa më shumë pjesëmarrës në diskutime publike, në mënyrë që t'ua japë mundësinë qytetarëve të jenë bashkë vendimmarrës në vendimet që ka nxjerrë Komuna e Obiliqit.

Në kuadër të kësaj kemi bërë një sërë aktiviteteve të mbledhjes me grupin komunal për konsultime publike, ku secili nga ta ka pasur detyra të ndara sa i përket dëgjimeve publike.

Me bashkëpunimin e secilit anëtarë të grupit dhe secilit akterë në Komunën e Obiliqit, gjatë vitit 2023 në komunën e Obiliqit ka pasur dukshëm përmirësime në pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultime publike. Raporti vjetor për konsultime publike vitin 2023 përfshinë dokumentet që janë konsultime me publikun, e për të cilat, konsultimi ka filluar nga data 01.01.2023 dhe është mbyllur më datë 31.12.2023. Raporti ka për qëllim të paraqesë punën e bërë gjatë vitit 2023 në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike. Raporti paraqet detajet dhe pjesëmarrjen e publikut në ofrimin e kontributeve të tyre, statusin e komenteve etj.

Numri i përgjithshëm i konsultimeve publike të realizuara gjatë vitit 2023 është gjashhtëmbëdhjetë (16) konkretisht:

1. "Plani për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale 2023-2027".
2. "Plani i veprimit për Transparencë Komunale".
3. "Prezantimi i Punës rreth hartimit të Hartave Zonale".
4. "Prezantimi i punës rreth hartimit të Hartave Zonale".
5. "Gratë në biznes, start-up dhe nënat vetë ushqyese".
6. "Revitalizimi i parkut tek kompleksi Banesor Hade 1-2, Projekt me USAID-in".
7. "Përmirësimi i kushteve të sigurisë në shkollat e Plemetinit, Projekt me USAID-in".
8. "Vlerësimi Strategjik Mjedisor".
9. "Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit".
10. "Plani Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit".
11. "Diskutim Publik me Kryetarët e Këshillave Lokal".
12. "Diskutim Publik me bizneset dhe ndërmarjet publike për Hartat Zonale".
13. "Plani Lokal i veprimit për Barazinë Gjinore".
14. "Strategjia Socio Ekonomike e Komunës së Obiliqit 2023-2027 me Kryetarët e Këshillave Lokal".
15. "Strategjia Socio Ekonomike e Komunës së Obiliqit 2023-2027 me qytetarë e komunës së Obiliqit".
16. "Statuti i Bibliotekës Komunale të Obiliqit".



Komuna e Obiliqit në muajin Qershor të vitit 2023, ka filluar pilot projektin për buxhetimin me pjesëmarrje me banorët e fshatit Mazgit i Epërm.

Buxhetimi me pjesëmarrje ka qenë pilot projekt që ka inkurajuar qytetarët që të luajnë rol të rëndësishëm dhe të vendosin se si të shpenzohen paratë publike për projekte në komunitetin ku ata jetojnë!

Qëllimi i kësaj iniciative është që t'u ofrohet qytetarëve mundësia për t'u përfshirë në mënyrë aktive në procesin e vendimmarrjes dhe të kenë një rol të drejtpërdrejtë në mënyrën se si shpenzohen fondet komunale. Ky proces është realizuar me ndihmen e USAID-it, programi “Agjenda e Kontratës Sociale” dhe janë realizuar 2 takime me qytetarët e fshatit Mazgit I Epërm.

- 1. Buxhetimi me Pjesëmarrje të Qytetarëve.***
- 2. Votimi i Projektit Buxhetimi me Pjesëmarrje të Qytetarëve.***



Po ashtu kryetari i komunës së Obiliqit, ka mbajtur dy (2) takime me qytetarët për informimin e punës së ekzekutivit.

- Informimi i qytetarëve rreth gjashtëmujorit (6) të parë të punës së ekzekutivit për vitin 2023.
- Informimi i qytetarëve rreth gjashtëmujorit (6) të dytë të punës së ekzekutivit për vitin 2023.



Gjatë vitit 2023, Komuna e Obiliqit ka realizuar gjithsej nëntë (9) dëgjime buxhetore.

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026.
2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026.
3. Gratë në biznes, start-up dhe nënat vetëushqyese, proces i Dëgjimeve Buxhetore.
4. Dëgjim Buxhetorë për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026.
5. Dëgjim Buxhetorë për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026, me Shoqërit Civile dhe HANDIKOSIN.
6. Dëgjim Buxhetorë për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026, me Kryetarët e Këshillave Lokal.
7. Kryesuesja e Kuvendit Komunal ka mbajtur, Dëgjim Buxhetorë për vitin 2024 dhe planifikimet për vitin 2025-2026.
8. Dëgjim Buxhetorë për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026, me Pensionistët e Komunës së Obiliqit.

9. Dëgjim Buxhetorë për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026, me Banorët e fshatit Plemetin.



Vlenë të theksohet se, në krahasim me vitin e kaluar ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesimi i publikut në procesin e konsultimit publik në vitin 2023 ishte më i lartë. Gjatë proceseve të konsultimeve publike, pjesëmarrësit kanë dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre. Sfidat kryesore që paraqiten gjatë konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këto proces. Me gjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Komuna e Obiliqit, ende nuk ka përfshirje shumë aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e dokumenteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim të përmirësimit të procesit, organizimi i konsultimeve publike është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të qytetarëve për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e dokumenteve dhe dëgjimeve buxhetore.



Numri i pjesëmarrësve në konsultime publike gjatë vitit **2022** ka qenë gjithsej **458**, nga ta **176** gra dhe **282** burra, ndërsa në vitin 2023 ka patur rritje të pjesëmarrjes së publikut në konsultime publike, numri i pjesëmarrësve në konsultime publike gjatë vitit **2023** ka qenë gjithsej **752**, nga ta **357** gra dhe **395** burra.

Festina Preniqi
Kordinatore për konsultime publike